

VENDIM
Nr. 54, datë 23.4.2015

**PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,
TË SHOQËRISË “EURON ENERGY GROUP” SHPK, MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 87, DATË 26.9.2011, TE SHOQËRITË
“ALB-ENERGY” SHPK, EURON ENERGY” SHPK DHE “ENERGAL” SHPK**

Në mbështetje të nenit 20, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 7 dhe nenit 149, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 4, nenit 17, pika 7, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 87, datë 26.9.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për miratimin e transferimit të licencës së prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., te shoqëritë “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Nga dokumentacioni i paraqitur në ERE nga shoqëritë “Euron Energy Group” sh.p.k., “ALB-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., sipas nenit 17 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezultoi:

Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k.

Neni 17, pika 4, germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 2, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Informacioni ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Vendimi me shkrim te organet drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës, i plotësuar në mënyrë korrekte;

Shoqëria “ALB-Energy” sh.p.k.

Neni 17, pika 2, germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3; germa “d”: Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike, i plotësuar: nuk ka asnjë modifikim apo ndryshim të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k.

Neni 17, pika 2, germa “a”: Format i aplikimit, sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, të plotësuara në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, plotësuar; germa “d”: Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike, i plotësuar: nuk ka asnjë modifikim apo ndryshim të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Shoqëria “Energal” sh.p.k.

Neni 17, pika 2, germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, të plotësuara në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, plotësuar; germa “d”: Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike i plotësuar: nuk ka asnjë modifikim apo ndryshim të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k. është në kushtet e ndarjes faktike në tri shoqëri të tjera, si më sipër, dhe me synimin për eliminimin e problemeve që mund të lindin si rrjedhojë e konsumimit të

afateve të plota procedurale, referuar nenit 7, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, të shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Bele 2”, me fuqi 11 MW dhe “Topojani 1”, me fuqi 2.9 MW, për një periudhë 26-vjeçare.

2. Transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, të shoqëria “Euron Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Bele 1”, me fuqi 5 MW dhe “Topojani 2”, me fuqi 5.8 MW, për një periudhë 26-vjeçare.

3. Transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, të shoqëria “Energal” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Orgjost i Ri”, me fuqi 4.8 MW, për një periudhë 26-vjeçare.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Euron Energy Group” sh.p.k., “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” dhe “Energal” sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti